Takimet e Liderëve nga Varshava prill 2012 - në Suzhou nëntor 2015

1. Takimi i I i Liderëve të Kinës-Vendeve të EQL dhe Forumi i II Ekonomik[1] *26 prill 2012, në Varshavë, Poloni*[2],
2. Takimi i II i Liderëve të Kinës-Vendeve të EQL dhe forumi i III Ekonomik. *26 nëntor 2013, në Bukuresht, Rumani*[3],
3. Takimi i III i Liderëve të Kinës-Vendeve të EQL dhe forumi i IV Ekonomik. *16 dhjetor 2014, në Beograd, Serbi*[4].
4. Takimi i IV i Liderëve të Kinës-Vendeve të EQL dhe forumi i V Ekonomik, 24-25 nëntor *2015, në Suzhou, Kinë*[5].
5. Takimi i V i Liderëve të Kinës-Vendeve të EQL dhe forumi i VI Ekonomik, *2016, në Letoni.*

I. Takimi i I i Liderëve në Varshavë dhe Platforma me 12 pika

Në forumin e Varshavës 2012, Ish- Kryeministri kinez, Wen Jiabao lançoi, Nismën e Bashkëpunimit Kinë – Vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore (EQL), (C-CEEC), e cila u shoqërua me platformën e bashkëpunimit prej 12 pikash, në favor të përfitimit reciprok dhe bashkëpunimit konkret në ekonomi, turizëm, infrastrukturë, energji të pastër, kulturë, arsim etj.

- ✓ *Edhe pse u prezantua në një kohë kur kriza globale financiare ishte në fazat më të avancuara, në veçanti në Greqi, Itali, Spanjë, Francë etj, ajo u vlerësua nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse.*

Në takim u diskutua mbi mundësitë dhe rrugët konkrete të bashkëpunimit, dhe pala kineze paraqiti 4 propozime.

1. Të forcojmë besimin reciprok, respektin e ndërsjellët, barazinë reciproke dhe kujdesemi për shqetësimet e njëri-tjetrit.
2. Të forcojmë bashkëpunimet konkrete në fushat ekonomike dhe tregtare.
3. Të forcojmë shkëmbimet kulturore dhe vlerësojmë në nivelin strategjik shkëmbimet rinore dhe të mediave.
4. Të shtojmë elemente të reja në marrëdhëniet kino-europiane.

---

[1] Konsiderohet i II pasi Forumi I-rë Ekonomik dhe Tregtisë midis Kinës-Vendeve të EQL është mbajtur në *qershor 2011 në Budapest, Hungari*,

[2] Mori pjesë Z. Edmond Haxhinasto, Zv. Kryeministër dhe Ministër i Jashtëm.

[3] Delegacioni shqiptar u kryesua nga KM z. Edi Rama, mori pjesë dhe Ministri Ekonomisë, z. Arben Ahmetaj.

[4] Delegacioni shqiptar u kryesua nga KM z. Edi Rama, mori pjesë dhe Ministri Ekonomisë, z. Arben Ahmetaj dhe Ministri Transporteve z. Haxhinasto dhe një delegacion biznesi.

[5] Delegacioni shqiptar kryesohet nga KM z. Edi Rama, mori pjesë dhe Ministri Transportit z. Edmond Haxhinasto.

Ky takim, mendohet se, ka kontribuar në sigurimin e mbështetjes politike, ligjore e financiare për këtë bashkëpunim midis këtyre vendeve dhe Kinës.

<u>12 pikat e Platformës së bashkëpunimit</u>

1. **U ngrit *Sekretariati i Bashkëpunimit Kinë – Vendet e EQL***, me qëllim që të koordinojë bashkëpunimin politik dhe ekonomik midis Kinës dhe 16 vendeve të EQL.
2. **U krijua një linje kredie me 10 miliard $** me karakterin e kredive të buta, që do të përdorej për projekte në *infrastrukturë, teknologjisë së lartë, ekonomisë së gjelbër* etj.
3. **U krijua Fondi i Bashkëpunimit për Investim**[6], 500 milion $ (faza I-rë *në formë bashkë-investimi nga Expot-Import Bank of China, kundrejt aksioneve në projektet që do të aprovohen.*). *Qëllimi i këtij fondi* ishte promovimi i *bizneseve të madhësisë mesatare* në vendet e EQL dhe do të përqendrohej në katër sektorë: energji, telekomunikacion, infrastrukturë dhe industrinë e specializuar.
4. **Nxitja e tregtisë dhe investimeve kineze drejt vendeve të EQL**. *Qëllimi arritja e një volumi biznesi prej 100 miliard $ deri në vitin 2015.*
5. **Nxitja e ndërmarrjeve kineze për të ndërtuar nga 1 park ekonomik me teknologji të avancuar** me këto vende në 5 vitet e ardhshme.
6. **Hapja e ndërsjellët e bankave dhe bashkëpunime të tjera financiare**[7]**.**

---

[6] *Në këtë fond deri tani kanë kontribuar Polonia dhe Hungaria (me 30 milion $) . Është ngritur dhe një grup pune me qendër në Varshavë, i cili vlerëson projektet e propozuara. Vlera e projekteve që preferon pala kineze është nga 20 – 50 mln USD, që prokurohen shpejt dhe kanë të përcaktuar detajet dhe kohën e shlyerjes së kredisë.. Këto projekte mund të paraqiten si nga kompani kineze, ashtu edhe nga kompanitë e 16 vendeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore. Aktualisht, në këtë fond janë përfshirë 16 projekte prioritare në infrastrukturë, telekomunikacion, hidrocentrale, ferma të erës, trajtimit të mbeturinave, prodhimit, etj. Janë duke u diskutuar dhe 3 projekte të tjera. Janë kontaktuar shumë emra të kompanive të mëdha në Kinë duke përfshirë Huawei, Inspur, Sinohydro, Gezhouba Group, CRBC, Fiber Home dhe China Hi-Tech Group Corporation.*

[7] Kina ka nënshkruar marrëveshje të këmbimeve valutore respektivisht me Hungarinë dhe Shqipërinë. *Banka e Shqipërisë, 12 shtator 2013 nënshkroi një marrëveshje dypalëshe SWAP*[7] *me Bankës Qendrore të Republikës Popullore të Kinës, në shumën maksimale prej 2 miliardë Yuan Kjo marrëveshje i hap rrugën Shqipërisë drejt emetimit të Juanbond-it, në monedhë kineze, si një mundësi e zgjerimit të tregut financiar edhe në tregun aziatik. Synon nxitjen e tregtisë dypalëshe dhe të investimeve direkte për zhvillimin ekonomik, mbështetjen e stabilitetit financiar.*

Institucionet bankare përkatëse në Poloni, Hungari dhe Lituani kanë investuar në tregun ndër bankar të bonove kineze.

7. **Ngritja e Komisionit të Konsultimeve** mes ekspertëve të Kinës dhe atyre të EQL mbi ndërtimin e rrjetit të transportit, autostradave ose të hekurudhave rajonale nëpërmjet sipërmarrjes dhe bashkëpunimit të përbashkët, kontraktimit të përbashkët etj. *Mundësia e lidhjes se Hekurudhës Ndërkombëtare Chongqing – Xinjiang – Evropë, si një kanal multimodal transporti, me vendet e EQL.*

8. **Forum i Bashkëpunimit Kulturor Kinë- Vende të EQL**, takime të rregullta mes personaliteteve të larta kulturore dhe ekspertëve, si dhe festivale kulturore dhe aktivitete me tema të caktuara.

9. **Dialog i Politikave të Arsimit mes Kinës dhe Vendeve të EQL,**[8] Kina do të ofrojë 5000 kuota për bursa në 5 vitet e ardhshme (16 vendet), do të ngrejë Institute të Konfucit dhe të klasave të Konfucit në këto vende, do të ftojë 1000 studentë në Kinë nga ky rajon të specializohen me gjuhën kineze.

10. **Ngritja e Aleancës për nxitjen e turizmit mes Kinës dhe vendeve të EQL.** *Qëllimi: të hapen bashkërisht linja të turizmit, më shumë fluturime të drejtpërdrejta, panaire, promovimi të produkteve të turizmit Kina-EQL etj. Është ngritur Qendra në Budapest.*

11. **Krijimi i Fondit të Studimit**. Pala kineze do të ofrojë 2 milionë RMB çdo vit, për të përkrahur zhvillimin e shkëmbimeve akademike mes institucioneve kërkimore dhe studiuesve.

12. **Forumi Parë i Politikanëve të Rinj** mes Kinës dhe vendeve të EQL.

II. <u>Takimi i II i Liderëve në Bukuresht dhe Udhërrëfyesi me 6 pika</u>

Më 26 nëntor 2013 u mbajt në Bukuresht, Takimi i II i Krerëve të Qeverive të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore – Kinë. Samiti u shoqërua edhe me Forumin e Ekonomisë dhe Tregtisë Kinë-vende të EQL. Morën pjese rreth 700 përfaqësues.

<u>*Qëllimi i Samitit:*</u> Thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të Kinës me 16 vendet anëtare të Nismës, duke synuar promovimin dhe dyfishimin e tregtisë dhe investimeve në pesë vitet e ardhshme.

---

[8] *Në Shqipëri, është rritur numri i nxënësve që mësojnë gjuhën kineze nga 10 në 70. Instituti i Konfucit në Shqipëri, u inaugurua në datën 18 nëntor 2013 pranë UT. Instituti Konfuci do të jetë një vlerë e shtuar për universitetin jo thjesht në drejtim të promovimit të gjuhës dhe kulturës kineze, por edhe në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Gjuha kineze po mësohet në dy shkolla publike, shkolla 9-vjeçare "7 marsi" dhe shkolla e mesme e përgjithshme "Sinan Tafaj" në Tiranë. Shpenzimet e qëndrimit dhe akomodimit të mësuesve kineze mbulohen nga qeveria kineze.*

Në Samit, u propozuan shtyllat kryesore të bashkëpunimit, bazuar në: rritjen e besimit reciprok politik midis vendeve, eksplorimin e potencialeve ekonomike dhe tregtare, krijimin e një baze të gjerë projektesh bashkëpunimi, si dhe forcimin e shkëmbimeve kulturore.

Në Samitin e Bukureshtit u prezantuan 38 projekte bashkëpunimi, 80% e të cilave u vunë në praktik. U ra dakord që të ndërtohet një linjë hekurudhore për trena të shpejtësisë së lartë, që do lidhë Serbinë me Hungarinë, dhe u premtua edhe lidhja me Rumaninë.

Udhërrëfyesi i Bukureshtit dhe 6 pikat e bashkëpunimit:

1. Forcimi bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, (*brenda 5 vjetësh synohet të dyfishohet volumi shkëmbimeve tregtare, 100 miliardë $ deri në fund të 2015)*
2. Promovimi i bashkëpunimit në fushën e infrastrukturës së transportit, me qëllim lidhjen tokësore dhe detare midis Kinës dhe Evropës. *(të krijohet një korridor logjistik "kinez" përgjatë linjës hekurudhore Chongqing – Roterdam/ Kinë-Evropë (në pjesën evropiane), duke krijuar zona lidhëse dhe qendra shpërndarëse nëpërmjet hekurudhave dhe porteve.*
3. Rritja e bashkëpunimit në ekonominë e gjelbër[9]. (*projektet ne energjitike, hydro, diellore, erës, energjisë bërthamore me teknologji të lartë).*
4. Zgjerimi i bashkëpunimit financiar. Ngritja në *tregjet e njëra-tjetrës degë të institucioneve financiare të tyre, si dhe nënshkrimi i marrëveshje për shkëmbimin e monedhës vendase dhe likuidimin e saj, si dhe më shumë lehtësira për tregtinë dhe fushën e investimeve.*
5. Të nxitet dhe inkurajohet bashkëpunimi në nivel lokal. (binjakëzime)

Në maj 2012, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë së Tiranës dhe Bashkisë së Nankinit, në Kinë (të binjakëzuara në vitin 2008) në fushën ekonomike dhe tregtare, administrimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës, (Pekini ka një eksperiencë të madhe në këtë fushë dhe bashkëpunimi do të jetë mjaft i rëndësishëm.

- ✓ *Në datat 8-11 qershor 2014, qyteti Ningbo, në Kinë organizoi Panairin e 13-të Ndërkombëtar Kinez për Mallrat e Konsumit, si dhe Javën e Shkëmbimeve Ekonomike dhe Kulturore midis qytetit Ningbo dhe vendeve EQL. Bashkia Ningbo, nënshkroi marrëveshjen e binjakëzimit me qytet-portin e Durrësit.*

Durrës-Shasntou (tbc)

[9] *Kina nënshkroi marrëveshje ndër-qeveritare për bashkëpunim në përdorimin paqësor të energjisë bërthamore respektivisht me Rumaninë, Republikën Çeke dhe Hungarinë.*

6. Të forcojnë bashkëpunimin kulturor, *duke organizuar forume të rregullta mbi kulturën dhe arsimin duke forcuar komunikimin midis politikanëve të rinj, grupeve të ekspertëve, mediave, etj.*

Fusha të tjera me interes për të bashkëpunuar u evidentuan edhe *bujqësia (*nevoja e Kinës për produkte mishi, bulmeti dhe verë të cilësisë së lartë, do të sjellë rritjen e tregtisë bujqësore midis palëve dhe *turizmi (*ka një interes në rritje të turistëve kinezë për të vizituar vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore). U hodh ideja e krijimit të organizatës së turizmit, që do të shërbejë si platformë për lehtësimin e turizmit reciprok dhe në njohjen e vizave të secilit vënd të rajonit.

III. Takimi III i Liderëve në Beograd[10] dhe Udhëzuesi i Beogradit

Takimi III i Liderëve të Kinë-Vende të EQI-s dhe Forumi IV Ekonomik, u zhvillua në 16-17 dhjetor 2014 në Beograd, Serbi. Samiti me temë: "New Driving Force, New Platform and New Engine". trajtoi çështje të bashkëpunimit ekonomik, tregtar, financiar, transport, bujqësor etj.

Udhëzuesi i Beogradit "Belgrade Guidelines for Cooperation between China and Central and Eastern European Countries", që u miratua përcaktoi drejtimet e bashkëpunimit për vitin 2015 që ishin: transporti, ekonomia, tregtia dhe investimet, bashkëpunimi financiar, shkenca, teknologjia dhe inovacioni, energjia, mjedisi, arsimi, turizmi, kultura, etj. Por edhe industria, manifaktura, telekomunikacioni dhe shëndetësia.

Udhëzuesi i Beogradit

- Përcaktoi drejtimet e bashkëpunimit mes Kinës dhe Vendeve të EQL për vitin 2015 që do të jenë: transporti, ekonomia, tregtia dhe investimet, bashkëpunimi financiar, shkenca, teknologjia dhe inovacioni, energjia, mjedisi, arsimi, turizmi, kultura, etj. Por edhe industria, manifaktura, telekomunikacioni dhe shëndetësia.

- Viti 2014 ju kushtua investimeve dhe biznesit, viti 2015 pati në fokus turizmin dhe propozoi një sërë aktivitetesh në këtë kuadër. Llogaritet qe çdo vit rreth 100 milionë kinez të vizitojnë Evropën si turistë.

- Risi e këtij viti ishte shëndetësia. U thirr në Ceki në qershor 2015 takimi i parë i Ministrave të Shëndetësisë.

- Në Transport, fokusi ishte transporti hekurudhor (trafiku i kontenierëve, parqet logjistike dhe qendrat e shpërndarje), por edhe infrastruktura tokësore, detare, hekurudhore dhe ajrore, në kuadrin e rrjeteve rajonale. Nisma synon të krijojë kushte për përmirësimin e infrastrukturës së rajonit duke i shërbyer kështu idesë për krijimin e "New Silk Road" që do të lidhë Azinë me Evropën.

[10] Delegacioni shqiptar u kryesua nga Kryeministri i RSH z. Edi Rama. Pjesë e delegacionit ishin dhe Ministri i Ekonomisë z. Arben Ahmetaj dhe Ministri i Transporteve z. Edmond Haxhinasto, si dhe një delegacion me përfaqësues nga biznesi.

- Lidhur me bashkëpunimin financiar, në kuadër të ngritjes së nivelit më të lartë dhe frytdhënës të bashkëpunimit Kinë-vende të EQL-s, Kina do të krijojë një fond investimi 3 miliardë dollarë për të lehtësuar dhe reduktuar koston e financimit të projekteve. Ndërsa lidhur me linjën e kredisë prej 10 miliard dollarë, tërhiqet vëmendja e shteteve për ta shfrytëzuar dhe pala kineze do të mundohet të kërkojë modele të reja financimi për investimet në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore.

- U deklarua se, faza e dytë e Fondit të Bashkëpunimit të Investimeve midis Kinës dhe vendeve të EQL-s do të rritet në 1 miliard dollarë. Kërkohet gjithashtu më shumë bashkëpunim midis institucioneve financiare për të krijuar degë, eksploruar tregun dhe zgjeruar bizneset.

- Bashkëpunimi ekonomik, tregtar dhe investimet, do të ketë në fokus rritjen e shkëmbimeve tregtare sidomos produkteve bujqësore dhe blegtorale, bashkëpunime mes bizneseve dhe dhomave të tregtisë, më shumë aktivitete në këtë kuadër. Priten modele të reja bashkëpunimi të partneritetit privat-publik, pasi ka shumë mundësi për të rritur, madje dyfishuar volumin tregtar mes Kinës dhe vendeve të EQL-s.

- Koordinatorët Kombëtare propozuan krijimin e një rrjeti komunikimi e shkëmbim informacioni mes tyre, në mënyrë që të sigurohet një koordinim më i mirë.

Sa u propozua për 2015, një pjesë e mirë e tyre ishin procese, projekte, aktivitete, të nisura në 2014 dhe që synojnë të zgjerojnë dhe thellojnë këtë bashkëpunim duke nxitur palët për ti mbështetur dhe çuar para ato.

IV. Takimi IV i Liderëve në Suzhou, Agjenda Afat Mesme (MTA) dhe Udhëzuesi i Suzhout

Takimi u mbajt në datat 24-25 nëntor në Suzhou, Kinë dhe shënoi një moment të ri në bashkëpunimin 16+1. Tema e takimit: "Pikënisje e re, sfera të reja, vizion i ri" ("Neë Beginning, neë domains and neë vision").

Në takim u miratuan dy dokumente, Agjenda Afat Mesme (MTA) për Bashkëpunim dhe Udhëzuesi i Suxhout. Të dy dokumentet synojnë të ndërtojnë një platformë bashkëpunimi në 10 fusha, si dhe planifikojnë ngritjen e më shumë se 10 mekanizma bashkëpunimi.

Agjenda afatmesme parashikon drejtimet e angazhimit të Nismës për 2015-2020 dhe synon ndërtimin e një ure tokësore të re Euro-aziatike dhe në zhvillimin e segmenteve ekonomik Kinë-Mongoli-Rusi, Kinë-Azi Qendrore - Azia Perëndimore dhe Kinë - Gadishulli Indokinë, duke përfituar nga rrugët ndërkombëtare të transportit, mbështetet në qytetet kryesore përgjatë kësaj rruge dhe përdorimin e parqeve kryesore ekonomike industriale si platforma të bashkëpunimit.

Qëllimi: Vendet e përfshira drejtpërdrejt apo tërthorazi në këtë brez,

- do përmirësojnë infrastrukturën e rajonit dhe ndërtojnë një rrjet të sigurt dhe efikas të rrugëve tokësore, detare dhe ajrore,
- do të thellojnë besimin politik dhe përmirësojnë bashkëpunimin midis tyre në një nivel më të lartë,
- mbajnë lidhje më të ngushta ekonomike, rritin shkëmbimet tregtare dhe lehtësojnë investimet,
- do të krijojnë një rrjet të zonave të tregtisë së lirë me standarde të larta,
- zgjerojnë shkëmbimet kulturore dhe njohin qytetërime të ndryshme për të mësuar nga njëri-tjetri,
- promovojnë mirëkuptimin e ndërsjellët, paqen dhe miqësinë midis njerëzve të të gjitha vendeve.

Udhëzuesi i Suzhout hartuar me një gjuhë praktike më shumë sesa juridike, shpalos dhe liston fushat kryesore të bashkëpunimit (konjektiviteti, financat, bujqësia, pyjet, shkencë, teknologji, shëndet, kulturë dhe bashkëpunimi në nivel lokal/bashki) aktivitete konkrete planifikuar për tu zhvilluar përgjatë 2016, aktivitete, shoqata e mekanizma të rinj.